

# AKT THEMELIMI

## I

### SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### " LYMPHA SHPK "

Sot, më datë 28/02/2024,

**Fabrizio Mario Lasagno** shtetas Italian, i ditëlindjes 03/04/1993, lindur në Carmagnola TO, mbajtës i letërnjoftimit me Nr YC2102195 zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

#### NENI 1

##### Themelimi

Emri i shoqërisë është " LYMPHA SHPK ". Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri " LYMPHA SHPK " Sh.P.K.

#### NENI 2

##### Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Objekti i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e: Prodhimit dhe formulimeve kimike në përgjithësi, ndërtimi dhe tregtimi i sistemeve teknologjike për trajtimin e ujit në përgjithësi, si dhe për rikuperimin dhe ripërdorimin e të njëjtit ujë në mënyrë që të sigurohet kursim uji dhe energjie; importi dhe eksporti i mallrave dhe produkteve joushqimore, duke përfshirë pajisjet dhe sistemet për industrinë në përgjithësi, produktet kimike të çdo lloji, shtesë për produktet ushqimore, produktet elektronike, automjetet logjistike dhe të ndërtimit, kozmetikën dhe produktet për higjenën personale, artikuj e letër dhe materiale te ngjashme dhe përveç aktiviteteve specifike të blerjes dhe shitjes së palëvizshme. Shoqëria mund të kryejë, gjithashtu sipas mandatit të një shoqërie tjetër, të gjitha aktivitetet të lidhura dhe te ngjashme me të vetët, që nuk marrin pjesë në shoqëri. Shoqëria Consortili dhe Konsorciumet që kanë objekt social të lidhur ose të ngjashëm me të tijn. Veprimtaria duhet të kryhet gjithashtu me korrespondencë, ose me ndihmën e mjeteve informatike ose telematike, si dhe në bazë të një marrëdhënie komisioni, agjencie ose përfaqësimi, me ose pa magazinimin e mallrave ose materialeve të shoqërive mandatuese. Të gjitha veprimet e mësipërme mund të kryhen nga shoqëria për llogari të saj ose për llogari të të tretëve, në Itali ose jashtë saj. Kompanisë i ndalohe të kryejë operacione që nuk lejohen me ligj ose në çdo rast të rezervuara nga ligji për forma të veçanta korporative, veçanërisht ato që synojnë mbledhjen e kursimeve nga publiku.

#### NENI 3

##### Emri dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin " LYMPHA SHPK " Sh.p.k dhe kompania do ketë vulën e saj.

FABRIZIO LASAGNO MARIO

## NENI 4

### Objekti i veprimtarisë

Objektivi i shoqërisë do jetë: Prodhimit dhe formulimeve kimike në përgjithësi, ndërtimi dhe tregtimi i sistemeve teknologjike për trajtimin e ujit në përgjithësi, si dhe për rikuperimin dhe ripërdorimin e të njëjtit ujë në mënyrë që të sigurohet kursim uji dhe energjie; importi dhe eksporti i mallrave dhe produkteve joushqimore, duke përfshirë pajisjet dhe sistemet për industrinë në përgjithësi, produktet kimike të çdo lloji, shtesë për produktet ushqimore, produktet elektronike, automjetet logjistike dhe të ndërtimit, kozmetikën dhe produktet për higjenën personale, artikuj e letër dhe materiale te ngjashme dhe përveç aktiviteteve specifike të blerjes dhe shitjes së palëvizshme. Shoqëria mund të kryejë, gjithashtu sipas mandatit të një shoqërie tjetër, të gjitha aktivitetet të lidhura dhe te ngjashme me të vetët, qe nuk marrin pjesë në shoqëri. Shoqëria Consortili dhe Konsorciumet që kanë objekt social të lidhur ose të ngjashëm me të tijin. Veprimtaria duhet të kryhet gjithashtu me korrespondencë, ose me ndihmën e mjeteve informatike ose telematike, si dhe në bazë të një marrëdhënie komisioni, agjencie ose përfaqësimi, me ose pa magazinimin e mallrave ose materialeve të shoqërive mandatuëse. Të gjitha veprimet e mësipërme mund të kryhen nga shoqëria për llogari të saj ose për llogari të të tretëve, në Itali ose jashtë saj. Kompanisë i ndalohet të kryejë operacione që nuk lejohen me ligj ose në çdo rast të rezervuara nga ligji për forma të veçanta korporative, veçanërisht ato që synojnë mbledhjen e kursimeve nga publiku.

## NENI 5

### Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Shkodres me adresë: Bashkia Vau Dejës, Fshati Stajkë, Nr.pasurie 380/8, zona kadastrale 3506.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## NENI 6

### Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100.000 (Njëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 kuotë ku kuota ka vlerën 100.000 lekë.

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare me emrin " LYMPHA SHPK" zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

**Fabrizio Mario Lasagno** shtetas Italian, i ditëlindjes 03/04/1993, lindur në Carmagnola TO, mbajtës i letërnjoftimit me Nr YC2102195 zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit ku një kuotë ka vlerën 100.000 lekë.

FABRIZIO LASAGNO MARIO



Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

## NENI 7

### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## NENI 8

### Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

## NENI 9

### Caktimi i Administratorit

Administrator caktohet Z. **Fabrizio Mario Lasagno** shtetas Italian, i ditëlindjes 03/04/1993, lindur në Carmagnola TO, mbajtës i letërnjoftimit me Nr YC2102195 me një mandat 5 vjeçar dhe ka të drejta totale përfaqësimi te kompanisë.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

## NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

## NENI 13

FABRIZIO LASAGNO MARIO



Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

#### NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

#### ORTAKËT THEMELUES

**Fabrizio Mario Lasagno**

FABRIZIO LASAGNO MARIO

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'FM' or similar initials, written in a cursive style.